

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR POLICINË E SHTETIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” që nga hartimi i tij ka pësuar disa herë rishikime e ndërhyrje të pjesshme, të cilat kanë ndikuar në strukturën, por dhe në zbatueshmërinë e disa prej dispozitave, ndaj kjo iniciativë ligjore ka si qëllim rishikimin në tërësi të ligjit dhe integrimin e përvojës së deritanishme dhe të gjitha ndryshimeve që ai ka pësuar që nga viti 2014, në një akt të konsoliduar.

Hartimi i projektligjit është bazuar në një analizë të kuadrit të mëparshëm ligjor për Policinë e Shtetit, në një vlerësim dhe analizë të thelluar të modeleve të ligjeve për policinë të vendeve të Bashkimit Evropian si Itali, Rumani, Kroaci, Slloveni dhe vendeve të rajonit nga të cilat janë reflektuar dhe përshtatur shumë elementë që lidhen me *strukturën e ligjit, modelet e strukturave dhe organeve vendimmarrëse, modelet e organizimit strukturor, kompetencat dhe kriteret e emërimit, lirimit, shkarkimit të autoriteteve, modele të sistemeve të motivimit, pranimi, ecurisë në karrierë, kompetencave policore, standarde dhe parime të ushtrimit të kompetencave dhe shumë aspekte të tjera*, për të hartuar një projektligj më bashkëkohor dhe të qëndrueshëm në raport me këto standarde, modele dhe parime.

Projektligji do të shërbejë gjithashtu për krijimin e infrastrukturës së domosdoshme ligjore për Policinë e Shtetit me synimin për t’ju përshtatur proceseve reformuese dhe integruese në fushën e rendit dhe sigurisë publike, sfidave aktuale në lidhje me kriminalitetin.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i propozimit është zgjidhja afatgjatë e disa prej problematikave kryesore të identifikuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Projektligji synon përmbushjen e rekomandimeve kryesore të organizmave të BE-së dhe atyre ndërkombëtare, si dhe të vendeve partnerë për krijimin e kapaciteteve apo strukturave të munguara në Policinë e Shtetit.

Projektligji synon gjithashtu përmirësimin e organizimit, menaxhimit, funksionimit të veprimtarisë së strukturave policore, proceseve e procedurave, zhvillimit profesional të punonjësit të policisë, ecurisë në karrierë etj., duke i përfruar me parimet e standardet e vendeve të BE, përmbushjen në mënyrë efektive të misionit të Policisë së Shtetit dhe rritjen e efikasitetit në përmbushjen e detyrave e përgjegjësiwe institucionale.

Në frymën e përgjithshme të tij projektligji garanton rritjen e transparencës së vendimmarrjes, përmirësimin e aspekteve të policimit të orientuara drejt policimit demokratik, forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe përmirësimin e marrëdhënies me qytetarin dhe shoqërinë civile.

Struktura e ligjit dhe organizimi i krerëve është propozuar në harmonizim dhe përputhje me të gjitha modelet e ligjeve të policisë të vendeve evropiane dhe atyre të rajonit. Struktura e ligjit krijon një organizim më logjik, më funksional dhe më afër qëllimit të ligjit që është përcaktimi dhe rregullimi i veprimtarisë policore në përputhje me kuadrin normativ në fuqi.

Pozicionimi i kompetencave dhe masave policore në fushën e rendit dhe sigurisë publike në krerët e parë të ligjit, aspekt që përbën thelbin e veprimtarisë policore, e lidh atë me funksionim, misionin, përgjegjësitë dhe mënyrën se si ato zbatohen përmes masave policore.

Mbledhja dhe trajtimi i informacionit policor, një aspekt po kaq i rëndësishëm sa dhe masat policore, i cili praktikisht e mëparshme ka qenë i fragmentuar në nene të ndryshme të tij është organizuar në një kre të veçantë. Ky riorganizim i jep informacionit policor peshën e duhur specifike në tërësinë e ligjit në përputhje edhe me konceptin e policimit drejtuar nga intelijenca, por nga ana tjetër, duke i kushtuar rëndësi të veçantë mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtave themelore të njeriut.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është pjesë e korpusit të akteve ligjore e nënligjore të propozuara në kuadër të masave për zbatimin e programit të Qeverisë 2021-2025 dhe prioriteteve në fushën e rendit dhe të sigurisë publike të parashikuara në Kreun “Shqipëria e Sigurtë” të këtij programi. Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në programin analitik të akteve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 28.12.2023 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji synon implementimin e policimit demokratik të orientuar tek shërbimi ndaj qytetarëve, rritjes dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe veçanërisht garantimit të aksesit e transparencës në ofrimin e tyre, përmes krijimit të një policie me kulturë profesionalizmi, integriteti dhe respekti për dinjitetin njerëzor dhe komuniteteve të cilave u shërben, një polici më të ndjeshme dhe më të përfshirë në përmbushjen e objektivave sociale si: dhënia e ndihmës dhe mbështetjes për grupet e cënueshme dhe të marginalizuara dhe viktimave të krimit, dhunës në familje, diskriminimit ose përjashtimit social.

Ky projektligj do të krijojë bazën e nevojshme për një rol dhe angazhim më proaktiv të policisë në identifikimin dhe adresimin rrënjësor të shkaqeve të krimit.

Me qëllim, rritjen e besimit të qytetarëve, organizatave dhe partnerëve vendase dhe të huaja ndaj policisë projektligji krijon mekanizmat e përshtatshëm për rritjen e transparencës dhe informimit të publikut në mënyrë të institucionalizuar dhe dinamike mbi veprimtarinë e policisë.

Përcaktimet ligjore mundësojnë thellimin e bashkëpunimit të policisë me agjencitë dhe palët e tjera të interesit dhe fuqizimin e komunitetit, rritjen e reagueshmërisë, komunikimit dhe ndërveprimit të tij me policinë për të identifikuar kërcënimet e

reja, për të parandaluar dhe ndihmuar në zbulimin e çdo shkelje të ligjit dhe për t'u përfshirë në proceset vendimmarrëse për përmirësimin e shërbimit policor.

Në pikëpamjen e organizimit strukturor, me qëllim, rritjen e efikasitetit në menaxhimin e kapaciteteve të policisë është parashikuar një infrastrukturë e përshtatshme organizative, e profilizuar, më e thjeshtë dhe më funksionale.

Projektligji do të sjellë përmirësimin e procesit të llogaridhënies, forcimin e rolit të mekanizmave të jashtëm të mbikëqyrjes, monitorimit dhe vlerësimit të performancës së policisë.

Nisur nga, nevoja për t'ju përgjigjur me kapacitete të specializuara në nivel qendror dhe vendor ndikimit të zhvillimeve teknologjike shfaqjes së formave të reja dhe sfiduese të krimit të organizuar, kërcënimeve të krimit kibernetik, pastrimit të parave, krimeve financiare etj., si dhe duke marrë në konsideratë se, policimi i së ardhmes do të jetë i bazuar në inteligjencë është krijuar infrastruktura e përshtatshme ligjore për modernizimin e mëtejshëm të policisë dhe policimit.

Me qëllim rritjen e autonomisë profesionale dhe funksionale të policisë përmes krijimit të kapaciteteve të qëndrueshme me ekspertizë profesionale e me integritet të lartë, projektligji garanton një sistem më transparent dhe funksional të promovimit dhe ecurisë në gradë dhe në karrierë në polici të bazuar në meritë dhe profesionalizëm, krijon fleksibilitet në menaxhimin e gradave të rolit zbatues dhe një sistem që krijon ripërtëritje dhe motivim të personelit policor.

Duke konsideruar përshtatshmërinë e arsimit policor si elementi kryesor i arritjes së profesionalizmit të policisë, projektligji adreson problematikën e një arsimimi të përgjithshëm duke e orientuar atë drejt profilizimit sipas fushave kryesore të veprimtarisë të Policisë së Shtetit, por njëkohësisht krijon edhe një sistem më konkurrues rekrutimi nga një spektër më i gjerë i burimeve të rekrutimit për të adresuar njëkohësisht vakancat në kapacitetet policore.

Projektligji mundëson një përkufizim më të qartë të autoritetit policor, ushtrimit dhe kufizimeve të tij duke u fokusuar në rregullimin e veprimtarisë policore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, duke shmangur përsëritjet e rregulimeve të veprimtarisë procedurale hetimore që mbështetet në përcaktimet e legjislacionit procedural penal në fuqi.

Projektligji përcakton në mënyrë më të plotë dhe të qartë shkeljet dhe masat disiplinore duke propozuar një sistem më efektiv të masave ndëshkuese dhe korrigjuese ndaj çdo veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me përcaktimet e tij dhe legjislacionit në fuqi.

Nga ana tjetër, projektligji parashikon skema trajtimi financiar dhe motivimi më të favorshme ndaj punonjësve të policisë si trajtimi i veçantë i shërbimit, certifikatat dhe medaljet e karrierës dhe arritjeve profesionale etj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE-SË (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *Acquis-in* e BE, por është në harmoni me praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian dhe rajonit për policimin demokratik, bazuar në angazhimin e Shqipërisë për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe partnerëve për forcimin e shtetit të së drejtës, krijimin e institucioneve demokratike, transparente, me integritet të lartë, të qëndrueshme dhe efikase në zbatimin e politikave shtetërore. Projektligji i propozuar ka konsideruar dhe reflektuar gjerësisht rekomandimet e vlerësimeve të organizmave dhe ekspertizës ndërkombëtare/evropiane/rajonale si rekomandimet e progres raportit të Komisionit Evropian, GRECO-s, OSCE, por edhe modeleve dhe standardeve të policimit, transparencës dhe integritetit, efikasitetit të menaxhimit dhe drejtimit policor, operacionalitetit, modernizimit dhe aspekte të tjera të shprehura në rekomandimet e ICITAP, EU4LEA, CIDS.

Konkretisht disa nga rekomandimet e GRECO-s që janë materializuar në këtë projektligj janë si më poshtë:

- politikat për ofrimin e shërbimeve shitesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës të konsiderojnë në mënyrën e duhur rreziqet për korrupsion dhe konfliktin e interesit.

- miratimi i rregullave për të hequr dorë nga dhurimet/sponsorizimet private për Policinë ose, minimalisht kufizimi i riskut të korrupsionit dhe konfliktit të interesit në këtë drejtim
- ngritja e një sistemi dhe caktimin e personave të trajnuar të besimit për të ofruar këshillim konfidencial mbi çështjet e etikës dhe integritetit për të gjithë stafin e policisë.
- hartimin e rregullave të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra për punonjësit e policisë.

Gjatë hartimit projektligjit u vlerësua e nevojshme që krahas modeleve Evropiane të organizimit strukturor dhe funksional të Policisë së Shtetit, të shqyrtoheshin edhe standardet e përcaktuara në disa direktiva të Bashkimit Evropian të cilat lidhen me bashkëpunimin policor, shkëmbimin e të dhënave dhe mbrojtjen e personave fizike, por edhe të përpunimit të të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale. Edhe pse ky projektligj nuk përafron në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian parashikimet e tij janë në harmoni me *acquis communautaire* të BE dhe praktikat më të mira për fushën e rendit dhe sigurisë publike të tilla si Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2016/680 e 16 prillit 2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” -Direktiva e Policisë, e cila konsiderohet si *lex specialis* për përpunimin e të dhënave personale në fushën e bashkëpunimit policor. Fryma dhe parimet e saj reflektohen në Kreun III “Mbledhja, administrimi dhe mbrojtja e informacionit policor”, duke përfshirë koncepte të direktivës si përpunimin e të dhënave, fshirjen apo anonimizimin e informacionit policor, ndalimin e të dhënave të individëve dhe subjekteve vetëm për shkak se i përkasin një origjine ose etnie të caktuar, bindjeje të veçantë fetare, orientimi seksual ose bindjeje politike apo i përkasin një lëvizjeje ose organizate, kur nuk parashikohet me ligj.

Gjithashtu neni 43 i ligjit të Policisë së Shtetit “Transferimi ndërkombëtar i të dhënave” dhe veçanërisht shkronja “c” e pikës 2 të tij është hartuar nën frymën dhe përafrimin e kësaj direktive duke parashikuar lejimin e transferimit të të dhënave kur është i nevojshëm për parandalimin, hetimin, zbulimin e veprave penale ose për

zbatimin e ndëshkimeve penale dhe shteti marrës duhet të garantojë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për përpunimin e të dhënave personale.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 17 krerë:

Në kreun e parë me titull “Dispozita të Përgjithshme” janë përcaktuar objekti, qëllimi, përkufizimet, misioni, juridiksioni, statusi i Policisë së Shtetit, parimet e veprimtarisë, fushat e veprimtarisë, funksionet e Policisë së Shtetit dhe shërbimet me pagesë të saj.

Në kreun e dytë me titull “Kompetencat e policisë dhe masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike” janë ri-konceptuar përcaktimet e këtij kreu duke reduktuar të gjitha veprimet procedurale që punonjësi i policisë i kryen në zbatim të procedurës penale dhe urdhrave të organeve kompetente. Një përcaktim i tillë do të ndihmojë në perceptimin e duhur, por edhe në disiplinimin e autoritetit policor brenda limiteve të ligjit dhe të drejtave e lirive të njeriut.

Fokusi i këtij kreu është vendosur kryesisht në veprimtaritë administrative policore, siç janë verifikimi i identitetit të personave, ndalimi i përkohshëm policor dhe rasteve të përcaktuara në projektligj.

Dispozitat përkatëse të këtij kreu parashikojnë kufizimin e rasteve të abuzimit të mundshëm me shoqërimin, kohën e qëndrimit të personave në ambientet e komisariateve të policisë dhe zgjatjen e procedurave administrative policore, duke e reduktuar kohën e qëndrimit të tyre në këto ambiente nga 10 në 5 orë.

Ky kre parashikon trajtimin e veçantë dhe kujdesin në rastin e zbatimit të masave policore ndaj kategorive të caktuara të personave si të miturit, personat me kufizime shëndetësore, psikologjike etj.

Në këtë kre gjithashtu përcaktohet detyrimi i identifikimit të punonjësit të policisë para marrjes së një mase policore, përdorimit të forcës apo përshkallëzimit të saj, detyrimi i dokumentimit dhe arsyetimit të veprimeve policore, si edhe konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave personale të personave.

Në kreun e tretë me titull “Mbledhja, administrimi dhe mbrojtja e informacionit policor” janë përcaktuar burimet e informacionit policor duke përfshirë të dhënat që policia mbledh gjatë procesit të shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave, të dhëna dhe fakte që sigurohen nga policia në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, si dhe për parandalimin e veprave penale; të dhëna që sigurohen nga të dhënat kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat Policia e Shtetit ka akses të drejtpërdrejtë ose me marrëveshje me autoritetin përkatës; dhe të dhëna të tjera që mblidhen për ushtrimin e përgjegjësiave të përcaktuara në ligje të veçanta.

Gjithashtu në nenin që sanksionon mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, lind nevoja për saktësimin e kuadrit ligjor për çdo rast hetimor, si atë procedural hetimor edhe veprimtarinë informative parandaluese, duke mundësuar vënien në dijeni në kohë të policisë për të marrë masa lidhur me zbulimin e autorëve të veprave penale, si dhe personave që ndihmojnë apo favorizojnë kryerjen e këtyre veprave.

Në këtë kre parashikohen kriteret e përgjithshme të përpunimit dhe administrimit të informacionit policor, komunikimit të të dhënave personale tek palët e treta dhe garantimit të sigurisë dhe konfidencialitetit në respektim të të drejtave të subjektit të të dhënave personale.

Në kreun e katërt me titull “Organizimi i Policisë së Shtetit” është ri-konceptuar organizimi të Policisë së Shtetit duke fuqizuar rolin e departamenteve si shtyllat kryesore të veprimtarisë policore dhe duke i garantuar atyre kapacitetet dhe autoritetin të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësiave në nivel shërbimi policor.

Në këtë kre është parashikuar organizim i departamenteve në nivel qendror dhe vendor, me drejtim dhe kontroll vertikal, të ngjashme me modelin aktual të departamentit të kufirit dhe migracionit, si një model më efektiv në kuadër të organizimit strukturor.

Ri-konceptimi i organizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në një strukturë qendrore, administrative, jo-operacionale të policisë me qëllim rritjen e efikasitetit menaxherial në drejtim dhe koordinim dhe zhvendosjen e kapaciteteve thelbësore në nivelin e departamenteve.

Në dispozitat përkatëse të këtij kreu është përcaktuar autoriteti i miratimit të strukturave dhe organizimit strukturor që garanton një raport të balancuar mes kontrollit demokratik civil dhe nevojës për fleksibilitet operacional për të përballuar sfidat dhe dinamikat në përballje me krimin:

- miratimi i kornizës organizative, limiteve organike dhe shpërndarjes territoriale të strukturës së përgjithshme të Policisë së Shtetit deri në nivel komisariati nga Ministri i Brendshëm;
- miratimi i shpërndarjes së kapaciteteve, organizimi i brendshëm i strukturave brenda kësaj kornize organizative dhe juridiksioni i tyre lëndor dhe territorial nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Gjithashtu është parashikuar ri-profilizimi i strukturave mbështetëse në polici me synim rritjen e prezencës civile në funksione administrative, menaxheriale (financë, teknologji informacioni, legjislacion etj.) dhe me qëllim uljen e barrës financiare dhe të përfitimeve nga statusi i punonjësit të policisë dhe rritjen e profesionalizmit në kryerjen e detyrave.

Në këtë janë përcaktuar edhe strukturat e veçanta, identifikimi në ligj i të cilave, të tilla si shërbimi kriminalistikës dhe arsimi policor, krijon mbështetjen e nevojshme ligjore për organizimin e tyre me akte të tjera të veçanta.

Në kreun e pestë me titull “Autoritetet”, ri-përcaktohen marrëdhëniet e ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike/Ministrit të Brendshme me Policinë e Shtetit, duke theksuar kontrollin administrativ, drejtimin politiko-strategjik, kontrollin buxhetor, orientimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe vlerësimin e përmbushjes së objektivave.

Në koherencë dhe në përputhje me përcaktimet në lidhje me organizimin e Policisë së Shtetit të propozuar në këtë projektligj janë përcaktuar ose zgjeruar kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorit të departamentit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu janë përcaktuar kriteret e emërimit dhe lirimit, mandatet e qëndrimit në funksion të autoriteteve drejtuese në nivel qendror dhe vendor si i Zëvendës Drejtorit të Policisë së Shtetit (i unifikuar me Drejtorin e Përgjithshëm), drejtorit të departamentit (4 vjet), është përcaktuar mandat për Drejtorët e Drejtorive Vendore

të Policisë (3 vjet) me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë dhe pavarësisë së tyre në detyrë, por nga ana tjetër edhe qarkullimin e nevojshëm të drejtuesve të policisë.

Në projektligj janë përcaktuar mekanizma për garantimin e transparencës në emërime apo vendimmarrjen me ndikim në aspekte kyçe të veprimtarisë së Policisë së Shtetit. Në këtë kuadër janë krijuar organe kolegiale si (Këshilli i Policisë, Këshillat e Emërimeve, Komisionet e Karrierës, Komisionet ad-hoc për përzgjedhjen e drejtuesve të lartë të policisë).

Risi është propozimi i konceptit të përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përmes një procesi konkurrimi.

Në kreun e gjashtë me titull “Pranimi, formimi dhe ecuria në karrierë”, është zgjeruar spektri i burimeve të pranimit në dy nivelet më të ulëta menaxheriale (roli zbatues dhe roli i parë drejtues) në Policinë e Shtetit në mënyrë të shkallëzuar dhe të balancuar, duke mundësuar plotësimin e nevojave të personelit, garantimin e karrierës brenda institucionit dhe përparësinë e kësaj kategorie, por edhe rritjen e konkurrencës dhe cilësisë së personelit të rekrutuar, përmes një procedure të qartë dhe me faza.

Në projektligj janë propozuar pranimet me konkurrim të shtetasve me arsim të mesëm të lartë, studentëve ekselentë, për nivelin e parë drejtues, duke marrë gradën “Nënkomisar”, pas arsimimit përkatës në institucionin arsimor të sigurisë publike.

Projektligji parashikon rekrutimin e punonjësve nga institucionet e tjera të sigurisë si Forcat e Armatosura, Gardës së Republikës, Policisë së Burgjeve, oficerët e policisë gjyqësore, pra vetëm në dy nivelet më të ulëta menaxheriale të Policisë së Shtetit, pas marrjes së arsimimit përkatës formues policor dhe duke u punësuar në gradat më të ulëta të këtyre niveleve.

Gjithashtu janë qartësuar kriteret e përgjithshme për aplikimin për pranim në Policinë e Shtetit. Risi në këtë kre është gjithashtu edhe përfshirja e konceptit të trajnimit të detyrueshëm në shërbim me qëllim garantimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale për përmbushjen e funksioneve policore.

Kategoritë e pranimit në rolet policore janë si më poshtë:

- Pranimi në rolin zbatues në polici nëpërmjet konkurrimit;
- Pranimi në rolin zbatues në Policinë e Shtetit nga institucionet e tjera të sigurisë;
- Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit nëpërmjet konkurrimit;

- Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit nga institucionet e tjera të sigurisë;
- Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit nga punonjësit e rolit zbatues me arsim të lartë;
- Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit i shtetasve të diplomuar në ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë;
- Pranimi në rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit i oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Në kreun e shtatë me titull “Karriera policore dhe menaxhimi policor”, përcaktohet sistemi i gradave dhe hierarkia e menaxhimit policor që përbëhet nga katër role policore (zbatues, i parë drejtues, i mesëm drejtues dhe madhor). Në këtë kre është parashikuar edhe procedura e emërimit të punonjësve të policisë përmes krijimit dhe funksionimit të Këshillave të Emërimeve në dy nivele atë qendror dhe vendor, përkatësisht për gradat “Inspektor“ deri në “Nënkomisar” dhe “Komisar” deri në “Drejtues i Parë”.

Në ndryshim nga praktika e mëparshme, gradat e rolit zbatues janë reduktuar vetëm në një gradë funksionale “Inspektor” me qëllim rritjen e fleksibilitetit për menaxhimin e punonjësve të këtij roli sipas nevojave operacionale të Policisë së Shtetit. Trajtimi financiar punonjësve të rolit zbatues do të jetë i diferencuar bazuar në vjetërsinë në detyrë dhe funksionit përkatës brenda kësaj grade.

Në këtë kre janë përcaktuar gjithashtu edhe kriteret e përgjithshme për ecurinë në gradë përfshirë afatin e qëndrimit në gradë, i cili nga “Inspektor” deri në “Nënkomisar” është 5 vjet, kurse për gradat e tjera deri në “Drejtues i Parë” 4 vjet duke krijuar një sistem të ecurisë në gradë më motivues për karrierën policore, përmes shkurtimit të kohës së qëndrimit nga grada në gradë.

Në vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të kohës së trajnimit kur nuk i kalon 6 muaj të pandërprerë gjatë vitit kalendarik.

Në këtë kre një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe arsimimit dhe kualifikimeve për fitimin e gradës ku është përcaktuar se punonjësi i policisë për të fituar gradën “Nënkomisar” dhe “Drejtues” duhet të përfundojë programin e arsimimit përkatës

dhe/ose programin e trajnimit përkatës, ndërsa për fitimin e gradave të tjera duhet të përfundojë programin e trajnimit përkatës. Në këtë mënyrë do të rritet niveli i arsimimit dhe kualifikimit të punonjësve të policisë si edhe konkurrenca për gradë, duke i shndërruar ato në kriterin bazë për konkurrimin për fitimin e gradës pasardhëse, ndryshe nga praktika e mëparshme kur këto trajnime/kualifikime realizoheshin pas marrjes së gradës pasardhëse.

Afati i qëndrimit në listë pritjeje për dhënien e gradës nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Nëse brenda këtij afati nuk bëhet e mundur dhënia e gradës, punonjësi i nënshtrohet konkurrimin të radhës.

Punonjësit të policisë i garantohet e drejta ankimit në komisionin e apelit në çdo fazë të procesit për fitimin e gradës.

Në kreun e tetë me titull “Të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të policisë”, në ndryshim nga praktika e mëparshme janë përcaktuar, plotësuar apo qartësuar disa detyrime të punonjësit të policisë. Në tërësinë e detyrimeve të punonjësit të policisë janë parashikuar edhe gatishmëria në shërbim, reagimi/ndërhyrja profesionale e punonjësit të policisë në një situatë të çastit, për të parandaluar një rrezik apo vepër penale edhe jashtë kohës së shërbimit, si edhe shmangia e kontakteve të papërshtatshme apo përdorimi i uniformës.

Në këtë kre janë reflektuar edhe rekomandimet e GRECO-s për ndalimin e dypunësimin të punonjësve aktivë të Policisë së Shtetit, për ndalimin dhe ndëshkimin e vendimeve hakmarrësve ndaj punonjësve të policisë që raportojnë paligjshmërinë apo nuk zbatojnë urdhrat e paligjshëm, ndalimin e punësimin brenda 1 viti nga ndërprerjen e marrëdhënieve me Policinë e Shtetit në subjekte të cilat kanë qenë nën mbikëqyrjen e tij ose kur ka marrë pjesë në komisionet/bordet për licencimin apo dhënien e lejeve për ushtrimin e aktiviteteve të tyre gjatë shërbimit policor. Ky kufizim është balancuar me kompensimin financiar me pagesë kalimtare për 1 vit kalendarik.

Në dispozitat e këtij kreu janë parashikuar gjithashtu kufizime në lidhje me pjesëmarrjen në veprimtari politike, greva dhe sindikata nga punonjësi i policisë por edhe detyrimin e transparencës në lidhje me veprimtarinë e Policisë së Shtetit përmes informimit të publikut të gjerë.

Në kreun e nëntë me titull “Marrëdhëniet, kushtet e punës dhe trajtimi i veçantë i punonjësit të policisë”, krahas parimeve që drejtojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit, në këtë projektligj, risi paraqet përfshirja e parimeve të trajtimit të punonjësve të policisë nga vetë organizata për të orientuar politikat e zhvillimit dhe menaxhimit të personelit të saj bazuar në meritokraci, transparencë, objektivitet dhe mosdiskriminim.

Propozohet një sistem më favorizues dhe dinjitoz për trajtimin financiar të punonjësit të policisë, ku komponentët e këtij trajtimi janë paga për gradë, shtesa për funksion e natyrë të veçantë pune, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi, ku vjetërsia e shërbimit bazohet jo vetëm në një pagë referuese për të gjitha nivelet, por mbi pagën për gradën më të ulët të rolit përkatës, duke mundësuar një trajtim financiar të shkallëzuar.

Në këtë kre është propozuar një skemë e trajtimit të veçantë të shërbimit për t’i dhënë mundësinë punonjësve të policisë të mbyllin karrierën policore pas 30 vite shërbimi në moshën 55 vjeçare duke përfutur këtë trajtim financiar për periudhën e mbetur deri në pensionin e plotë të pleqërisë, por gjithashtu pa cenuar edhe të drejtën e dy-punësimit sipas legjislacionit në fuqi. Kjo skemë do të garantojë një rifreskim të trupës policore dhe përballohet nga buxheti i Policisë së Shtetit.

Një tjetër aspekt i trajtimit financiar të propozuar është edhe shpërblimi i menjëhershëm në masën e 6 (gjashtë) pagave kur punonjësi i policisë përfiton trajtim të veçantë shërbimi ose del në pension pleqërie.

Ofrimi i kredisë me interesa të butë për strehim për punonjësit e policisë, sigurimit shëndetësor të veçantë dhe kompensimit në rastet e plagosjes dhe dëmtimit të shëndetit të punonjësve të policisë janë një tjetër aspekt i rëndësishëm i trajtimit të punonjësit të policisë.

Risi është gjithashtu edhe përfshirja dhe garantimi me ligj i mbështetjes psikologjike për punonjësit e policisë në rast të përjetimit të stresit dhe gjendjes së rënduar psikologjike gjatë dhe pas kryerjes së detyrave policore.

Në kreun e dhjetë me titull “Transferimi” është kufizuar transferimi i punonjësve të policisë pa kriter dhe i pabazuar në nevoja konkrete operationale. Në projektligj është propozuar edhe një mekanizëm kontrolli përmes një procedure të qartë për

kufizimin e transferimit të punonjësve të policisë pa mbushur afatin minimal të qëndrimit në detyrë prej 2 vitesh dhe nga një shërbim policor në tjetrin, me qëllim garantimin e zhvillimit profesional të punonjësve, qëndrueshmërisë dhe profilizimit të tyre. Dy kritere të rëndësishme të propozuara në këtë drejtim janë motivimi i vendimit të transferimit dhe miratimi/informimi i Ministrit të Brendshëm në këto raste.

Në kreun e njëmbëdhjetë me titull “Ndërprerja e marrëdhënieve të punës” janë përcaktuar kriteret për lirimin e punonjësve të policisë, ku ndër të tjera janë përfshirë rastet kur ndaj tij ka nisur një procedim penal dhe është dhënë masa e sigurisë “arrest me burg” dhe “arrest në shtëpi”; nuk pajiset me Certifikatën e Sigurisë së Personelit; për performancë të ulët në një periudhë dy vjeçare dhe kur nuk përmbush kërkesat e trajnimit të detyrueshëm në shërbim (norma të përgatitjes fizike, të qitjes me armë, të vetëmbrojtjes).

Gjithashtu janë parashikuar edhe rastet për përjashtimin nga Policia e Shtetit të punonjësve kur dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale; kur me vendim të formës së prerë pas hetimit disiplinor merret masa disiplinore e përjashtimit dhe ndër të tjera kur deklaron të dhëna të rreme në formularët e vetëdeklarimit.

Rikthimi në Policinë e Shtetit është parashikuar të mundësohet vetëm përmes një procesi konkurrimi, kur ka kuota të lira për gradën që punonjësi i policisë ka pasur në momentin e lirit dhe pas certifikimit të njohurive në gradën përkatëse, duke e kthyer atë nga një rast preferencial në një burim transparent dhe cilësor për plotësimin e nevojave në Policinë e Shtetit.

Personi që rikthehet në Policinë e Shtetit brenda një periudhe 2-vjeçare emërohet në funksione me gradën që ka pasur në kohën e lirit.

Personi që rikthehet pas kësaj periudhe i nënshtrohet konkurrimit për certifikimin e njohurive dhe emërohet në funksione që i korrespondojnë një grade më të ulët sesa grada që ka pasur në kohën e lirit.

Në kreun e dymbëdhjetë me titull “Disiplina” propozohet shtimi i numrit të masave disiplinore, për ta bërë më elastik dhe të larmishëm sistemin e ndëshkimeve disiplinore.

Në këtë kre janë përcaktuar llojet e shkeljeve disiplinore, parashikimi i masave parandaluese me efekt korigjues para aplikimit të procedimit disiplinor, ashpërsimi i masave disiplinore, rritja e efektit të tyre parandalues dhe ndëshkues, duke i shoqëruar me efekte financiare, me masa plotësuese disiplinore me efekt korigjues por edhe edukues/trajnues si edhe afatet e parashkrimit të tyre.

Aplikimi gjithashtu i masave disiplinore me ndikim në sistemin e karrierës policore si ulja në gradë me afat 2 vjeçar dhe pa afat, si dhe shtyrja e afatit të gradimit.

Nga ana tjetër, janë propozuar në projektligj mekanizma mbështetës në përputhje me rekomandimet e GRECO-s, si Këshillat Konfidencialë të Policisë së Shtetit, që ofrojnë këshillim konfidencial për punonjësit e Policisë mbi çështjet e etikës, integritetit, korrupsionit, konfliktit të interesit, konfidencialitetit dhe çështje të lidhura me to.

Në kreun e trembëdhjetë me titull “Vlerësimi i performancës”, janë përcaktuar kriteret e përgjithshme të vlerësimit të performancës (realizimi i objektivave dhe sjellja dhe kompetencat profesionale). Gjithashtu është parashikuar se punonjësi i policisë vlerësohet edhe për komponentët e trajnimit të detyrueshëm në shërbim. Në këtë kre janë përcaktuar llojet e vlerësimeve dhe autoritetet që kryejnë vlerësimin e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Në këtë kre është parashikuar gjithashtu edhe zhvillimi i një sistemi motivimi dhe mirënjohjeje përmes medaljeve dhe certifikatave bazuar në vjetërsinë në shërbim dhe meritën në kryerjen e detyrave policore të shoqëruara me stimuj në vlerë monetare.

Në kreun e katërmëdhjetë me titull “Bashkëpunimi i policisë”, është vendosur **theksi tek** bashkëpunimi me komunitetin, shoqërinë civile dhe institucionet shtetërore, administratën zgjedhore dhe inspektoratet kompetente në fushën e ndërtimit, kontrollit të mjedisit dhe territorit, si edhe zhvillimi i policimit vullnetar.

Në këtë kre është parashikuar në një nen të veçantë bashkëpunimi i policisë me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për: parandalimin e krimit, në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, duke respektuar pavarësinë e tyre; hartimin në nivel vendor të masave për policimin në komunitet, në përputhje me procedurat e përcaktuara me Rregulloren e Policisë; planifikimin dhe koordinimin mes tyre të masave në fushën

e rendit dhe sigurisë publike; shkëmbimin e informacionit problematikat dhe informimin mbi zbatimin dhe masave për rendin dhe sigurinë publike.

Në kuadër të krijimit të një bashkëpunimi më të ngushtë me njësitë e vetëqeverisjes vendore, drejtuesit vendorë të policisë paraqesin një raportim vjetor tek organi i zgjedhur i njësisë vendore përkatëse për çështjet e rendit e të sigurisë publike, masat e marra dhe detyrat e përcaktuara për përmirësimin e saj.

Në projektligj është parashikuar në mënyrë më të zgjeruar bashkëpunimi ndërkombëtar i Policisë së Shtetit, veçanërisht përmes rolit të oficerëve ndërlidhës dhe autoriteti i ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike për të caktuar oficerë kontakti të Policisë së Shtetit model i ngjashëm me të gjitha vendet por edhe me institucionet e tjera shtetërore në vend, siç janë MM, SHISH, Dogana, etj.

Përmes parashikimeve në këtë kre synohet rritja e transparencës dhe mekanizmave të llogaridhënies, përmes raportimit dhe informimit të publikut, dhe pranimi të mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm.

Risi në këtë kre është gjithashtu edhe parashikimi i krijimit dhe funksionimit të Pikës Kombëtare të Informacionit për Ndeshjet Ndërkombëtare të Futbollit (PKINNF). PKINNF do të veprojë si pikë qendrore e drejtpërdrejtë për shkëmbimin e informacionit përkatës dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në lidhje me ndeshjet e futbollit me dimension ndërkombëtar.

Shtimi i Pikës Kombëtare të Informacionit për Ndeshjet Ndërkombëtare të Futbollit, diktohet nga procesi i përafrimit të legjislacionit me atë të BE (Kapitulli 24). Konkretisht gjatë procesit të skanimit dhe analizës së përafrimit të legjislacionit, është konstatuar se vendi jonë nuk ka legjislacion për sa parashikohet në Direktivën e Këshillit të Bashkimit Evropian 2002/348/JHA, të datës 24.4.2002, lidhur me sigurinë në ndeshjet e futbollit me dimension ndërkombëtar. Gjithashtu, në nenin 11 “Bashkëpunimi ndërkombëtar”, i Konventës të Këshillit të Evropës “Mbi një qasje të integruar për rendin, sigurinë dhe shërbimet në ndeshjet e futbollit dhe aktivitetet e tjera sportive”, e cila është miratuar në parim me vendimin nr. 853, datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave, kërkohet të ngrihet një pikë kombëtare për shkëmbimin e informacionit për ndeshjet e futbollit me dimension ndërkombëtar.

Në kreun e pesëmbëdhjetë me titull “Monitorimi i brendshëm dhe i jashtëm i policisë”, risi është parashikimi për herë të parë i llojeve të monitorimit, burimeve dhe kriterëve të tyre, si mekanizma për kontrollin demokratik civil të brendshëm dhe organeve të jashtme mbikëqyrëse. Zhvillimi i një neni të veçantë për vlerësimin e performancës së strukturave të Policisë së Shtetit duke përcaktuar kriteret e vlerësimit, autoritetet vlerësuese dhe llojet e vlerësimit.

Gjithashtu me qëllim rritjen e performancës menaxheriale të drejtuesve të strukturave policore është parashikuar edhe fillimi i procesit disiplinor për drejtuesin e strukturës policore të vlerësuar/inspektuar, nëse treguesit e performancës së saj, të vlerësuar përmes procesit të monitorimit të brendshëm dhe/ose të jashtëm, nuk janë realizuar brenda një periudhe 1 vjeçare dhe kur nga organet audituese/inspektuese rekomandohet të ndërmerren masa disiplinore apo administrative. Nëse nga procedimi disiplinor rezulton mosrealizimi i treguesve të performancës së strukturës së vlerësuar, drejtuesi i kësaj strukture lirohet nga detyra dhe ulet me një gradë.

Në kreun e gjashtëmbëdhjetë me titull “Mbështetja e Policisë” përcaktohet se punonjësi i policisë gjatë ushtrimit të funksioneve të tij përdor armë, mjete, pajisje, simbole, uniformën policore dhe shenjat e policisë. Rregullat specifike të përdorimit të tyre parashikohen në akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Gjithashtu në këtë kre parashikohet ndalimi i donacioneve, me përjashtim kur ato anonimizohen si p.sh. nga organizmat përfaqësuese të komunitetit të biznesit, siç janë Dhoma Kombëtare e Tregtisë, etj. dhe në çdo rast vetëm me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ky kre përfshin edhe dispozitat për buxhetin e policisë i cili është program i veçantë brenda buxhetit të ministrisë, i emërtuar “Policia e Shtetit” dhe drejtuesi i tij është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, si edhe fondin e veçantë që arrin maksimumi 1% të buxhetit vjetor të Policisë së Shtetit, për të shpërblyer personat e punësuar për operacione speciale policore, informatorë dhe për programe për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Në kreun e shtatëmbëdhjetë me titull “Dispozita kalimtare dhe përfundimtare”, parashikohen akteve nënligjore që duhet të dalin për zbatimin e këtij ligji, dispozitat kalimtare, shfuqizimi i ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e

Shtetit”, i ndryshuar si dhe dispozitave të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e policisë dhe bien ndesh me këtë ligj. Në përfundim të këtij kreu parashikohet hyrja në fuqi i e ligjit 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Ministria e Brendshme. Projektvendimi është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektakt shoqërohet me kosto financiare të cilat mbulohen nga buxheti i Policisë së Shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI I BRENDSHËM

Taulant Balla